

## Procesverbal

Për: Anëtarët e Këshillit të Fakultetit

Kryesuesja e KFSHJM: Albana Milaimi  
Skender Kokollari, Sekretar/procesmbajtës

Datë: 15.12.2023



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së përbashkët: BKI - KFSHJM - STUDENTË

### **Bordi Këshilldhënës Industrial**

### **Këshilli i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit**

### **Përfaqësuesit e studentëve të FSHJM**

Mbledhja u mbajt më datën: **15.12.2023** në orën **10:00** në objektin e Universitetit “Ukshin Hoti”, në Prizren në Zyrën e Dekanes së FSHJM-së si dhe pjesëmarrësit on-line të cilët u lidhën përmes platformës elektronike të dërguar nga Dekanja, Prof.asoc.dr. Albana Milaimi.

**KFSHJM: Në mbledhje morën pjesë:** Albana Milaimi – kryesuese, Prof.asoc.dr. Ylli Kortoçi, Prof.asoc.dr. Faruk Bojaxhi – anëtar, Prof. Asoc. Dr. Kushtrim Braha-anëtar , Prof. Asoc. Dr. Mirvjena Këllezi-anëtare, Ass. Liridon Buqaj-anëtar, Skender Kokollari – anëtar Beslinda Himaj - anëtare nga radhët e studentëve, Bukuriye Likaj Sokolaj – shërbimi i studentëve (pa të drejtë vote) dhe Fatlind Bajraktari –anëtar student ex-officio (pa të drejtë vote). – Mungoi: Prof.ass.dr. Nol Krasniqi.

**BKI-** Refki Zogaj, Ismet Gashi, Besim Loshi (on line), Evelina Ajazaj (on line), Vesël Usaj (on line), Dekanja dhe Sekretari i FSHJM si anëtarë ex officio të BKI-së.

Mbledhjen e hapi **Kryesuesja e Këshillit të Fakultetit** e cila konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe përshëndeti të pranishmit dhe lexoi pikat e rendit të ditës.

### **REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim dhe vendosje lidhur me kuotat për transfer të studentëve për vitin akademik 2024/25 në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit;
3. Diskutim me BKI-në dhe studentët rreth propozimit/eve dhe miratimit të listës finale të lëndëve për ri-akreditim të programeve:
  - Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit Bsc.
  - Agrobiznes Bsc.
  - Menaxhim në Agrobiznes Msc.
4. Të ndryshme: ( Ri-përtrirja e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe Bizneseve, Kërkesat për studentët: Gentian Cikaqi, Florent Ramadanaj, Erzen Pulaj dhe anda Dodaj, Mandatimi i Dekanes për zëvendësimin e Prof.asoc.dr. Ekrem Gjokaj në komisionet e FSHJM)

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.**

**Kryesuesja e KFSHJM,** Kryesuesja, kërkoj nga të pranishmit koment në lidhje me rendin e ditës dhe pas konfirmimit të të pranishmëve u miratua njëzëri rendi i ditës.

**2. Diskutim dhe vendosje lidhur me kuotat për transfer të studentëve për vitin akademik 2024/25 në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit;**

**Kryesuesja e KFSHJM:** lexon pikën 2 të rendit të ditës dhe hap diskutimin.

**Prof.asoc.dr. Kushrim Braha:** Vetëm kuotat që lirohen nga ç'regjistrimet eventuale të jenë të lira për transfer. Në vitin e parë të mos aprovohet asnjë kuotë për studentë. Studentët e interesuar në vitin e parë mund të regjistrohen përmes konkursit.

**Prof.asoc.dr. Mirven Këllezi:** A është e mundur që mbi numrin e aprovuar të lejohet kuota për transfer. – Përgjigja: jo vetëm brenda numrit të aprovuar që është 50, 80 dhe 15.

**Prof.asoc.dr. Albana Milaimi:** Mbështesë në tërësi propozimin e Profesor Kushtrimit, që për vitin e parë të studimeve nuk ka nevojë për kuota dhe transferi të lejohet vetëm për pozitat që lirohen nga ç'regjistrimet eventuale në vitet pasuese.

Hudhet në votim: Aprovohet njëzëri propozimi i Prof. Kushtrim Brahës dhe Prof. Albana Milaimit.

**3. Diskutim me BKI-në dhe studentët rreth propozimit/eve dhe miratimit të listës finale të lëndëve për ri-akreditim të programeve:**

- **Shkencat ePyjeve dhe Mjedisit Bsc.**
- **Agrobiznes Bsc.**
- **Menaxhim në Agrobiznes Msc.**

**Kryesuesja e KFSHJM:** Duke lexuar pikën 3 të rendit të ditës, rikujton se lista e lëndëve ka kaluar ciklin e rishikimit nga Koordinatorët e programve dhe Komsioni i studimeve të FSHJM-së.

Ftojme BKI-në dhe studentët të paraqesin propozimet eventuale:

**Kryesuesja e KFSHJM:** Prezanton listën e lëndëve në programin Menaxhim në agrobiznes Msc. duke lexuar lëndët për këtë program dhe i jep fjalën Profesor Kushtrim Braha që të prezantoj lëndët për programin.

**Prof.asoc.dr. Kushrim Braha:** Duke filluar me elaborimin e ndryshimeve thekson se nuk ka ndonjë ndryshim substancial. Një kërkesë që ka ardhur edhe nga ekspertët ndërkombëtarë është zgjerimi i mundësisë së zgjedhjes së lëndëve zgjedhore jo vetë në njësinë tonë akademike por edhe në Universitete tjera. *Lëndë me zgjedhje të lirë* që nuk është në kornizën e programit, por të cilën gjë për shkak të vështirësive në zbatim që mund të na krijoj kjo, propozoj që të zbatohet vetëm brenda Universitetit si fazë fillestare me mundësi të zgjerimit edhe në Universitete tjera në të ardhmen. Ndërsa në pjesën e praktikës profesionale duhet të zgjerohemi përtej punës praktike, pse jo të krijojmë kuadro profesionale të gatshme për tregun e punës duke thelluar bashkëpunimin Unversitet- Student-Biznes.

**a) Menaxhim në Agrobiznes Msc. PROPOZIMET E BKI-së dhe Studentëve:**

**BKI - Z. Besim Loshaj:** Tregu kërkon njohuri rreth ambientit dhe në këtë drejtim propozoj të vendoset si lëndë zgjedhore lënda **Agroekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit** në vend të **Menaxhim i teknologjisë së prodhimit shtazor** si lëndë më e ngarkuar dhe e ngushtë profesionale.

**BKI- Z. Refki Zogaj:** E mbështet propozimin e z. Loshaj duke e cilësuar si shumë të qëlluar lëndën **Agroekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit** si trend i vetëdijësimit të shoqërisë ndaj mjedisit.

**BKI:** Hedhet në votimin propozimi i BKI-së. Aprovohet njëzëri nga BKI.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së :** Lista e përbashkët e propozuar nga Komisioni i Studimeve dhe BKI hedhet në votim dhe aprovohet njëzëri nga KFSHJM për programin:

**Menaxhim në Agrobiznes Msc. – Shih listën në shtojcën nr. 1 të këtij procesverballi**

**b) Agrobiznes Bsc. PROPOZIMET E BKI-së dhe Studentëve:**

**Propozim i studentëve - Beslinda Himaj:** Të futet edhe lënda e Gjuhës Angleze II, në programin e Agrobiznesit.

**Prof.asoc.dr. Kushtrim Braha:** Propozimi i studentëve është në përputhje edhe me kërkesat e ekspertëve të cilët kanë kërkuar që të rritet fondi i orëve të ligjërimit në gjuhë angleze.

Por, fillimisht neve na duhet një lloj dëshmie (certifikate) që studentët e kanë nivelin e mjaftueshëm të gjuhës angleze për të ndjek ligjeratat në gjuhën angleze. Ideja është që lëndët profesionale të ligjerohen në gjuhë angleze. **Propozohet lënda gjuhë angleze për Agrobiznes.**

Si pikë pozitive në programin e Agrobiznesit është puna praktike e studentëve në komitetin e biznesit dhe përgaditja e tyre për tregu e punës. Praktika realizohet sipas profilit dhe bizneset mbështesin studentët në fazën e punës praktike si rezultat i interesit reciprok punën marrës-punë kërkuar.

Sfidë mbetet pjesa e mobilitetit të studentëve në nivelin baçelor dhe master. Dhe në këtë drejtim vlerësoj që duhet të shtohet bashkpunimi me Universitetet nga Shqipëria për shkak mundësisë më të lehtë të bashkëpunimit si dhe ngajshërive në planprogram.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së :** Lista e përbashkët e propozuar nga Komisioni i Studimeve, BKI si dhe propozimet e studentëve hedhet në votim dhe aprovohet njëzëri nga KFSHJM për programin:

**Agrobiznes Bsc. – Shih listën në shtojcën nr. 2 të këtij procesverballi**

**c) Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit Bsc. PROPOZIMET E BKI-së dhe Studentëve:**

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Pjesa kryesore e rekomandimit të ekspertëve për këtë program kanë qenë të natyrës teknike, por kemi pas edhe rekomandim për futjen e Gjuhës Angleze. Tani duke vepruar sipas rekomandimeve kemi Gjuhën Angleze I dhe Gjuhën Angleze II - zgjedhore.

Kemi po ashtu propozimin për futjen e lëndës: Ndotja dhe Mbrojtja e Mjedisit, semestri II viti parë – obligative, ndërsa tek lëndët zgjedhore kemi zgjeruar listën e lëndëve zgjedhore përveq lëndve ekzistuese duke e pasuruar listën me lëndë zgjedhore, si: Gjuhë angleze II, Bazat e Statistikës,

Dendrokronologjia, Menaxhim i Zonave të Mbrojtura, Rekreacion Pyjor dhe Turizëm, Monitorim i Popullatave Shtazore, Matja e Sipërfaqeve në Pyje dhe Pylltaria Urbane.

Fton Prof.asoc.dr. Mirvjena Këllezit për të bërë prezantimin e lëndëve në programin: Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit.

**Prof.asoc.dr. Mirvjena Këllezi:** Me qëllim që të krijojmë hapsirë të përfshirjes së lëndëve të reja kemi bërë bashkimin e lëndëve ekzistuese aty ku kemi pas mundësi dmth ku kemi vlerësuar se kemi përsëritje të lëndës ndërsa lëndët si: Inxhinieringu i pyjeve (akcesi në pyll), si dhe Prodhimi pyjor i kemi kaluar nga lëndë zgjedhore në obligative.

Pjesën e lëndëve zgjedhor e kemi zgjeruar ngase kemi vlerësuar se ka qenë e varfër lista e lëndëve zgjedhore dhe tani studenti ka mundësi që edhe të profilizohet pak a shumë në bazë të lëndëve zgjedhore.

**BKI- Evelina Ajazaj:** Nga çka kam pas rast me pa në përvojën time e vlerësoj si të nevojshme edhe lëndën: **Monitorimi i Kafshëve të Egra.** Kjo lëndë do të ishte mirë të jetë lëndë obligative.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Në bazë të rekomandimeve të ekspertëve si dhe të Komisionit të studimeve nuk ka hapsirë që në këtë fazë kjo të jetë obligative për faktin se në procesin e riakreditimit ndryshimi i lejuar është 30%. Propozimi i juaj që lënda në fjalë të bëhet si lëndë obligative do të mbetet në pritje për procesin e radhës.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së :** Lista e përbashkët e propozuar nga Komisioni i Studimeve, BKI si dhe propozimet e studentëve hedhet në votim dhe aprovet njëzëri nga KFSHJM për programin:

**Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit Bsc. – Shih listën në shtojcën nr. 3 të këtij procesverballi**

**4. Të ndryshme: (Ri-përtrirja e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe Bizneseve, Kërkesat për studetët: Gentian Cikaqi, Florent Ramadanaj, Erzen Pulaj dhe anda Dodaj, Mandatimi i Dekanes për zëvendësimin e Prof.asoc.dr. Ekrem Gjokaj në komisionet e FSHJM):**

- **Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Ri-përtrirja e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Universitetit dhe Bizneseve: Kërkojmë që të iniciojmë ripërtrirjen e marrëveshjeve (memorandumeve të bashkëpunimit) aktuale si dhe krijimin e marrëveshjeve të reja për mbulimin e punës praktike.

**BKI- Ismet Gashi:** Unë propozoj që Universiteti të lidh marrëveshje bashkëpunimi ndërmejt Universitetit dhe Qendrës së Biznesit e cila mbulon bizneset. Ne dërgojmë listën e bizneseve ku mund të zhvilloni punën praktike për studnetët tuaj.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** OK, atëherë për Kompanitë që mbulon Qendra e Biznesit të bëhet një marrëveshje e re ndërsa me Organizata tjera jashtë kësaj të lidhen marrëveshje të reja me biznese, OJQ apo organizata tjera edhe nga regjione të tjera si Rahovec, Dragash dhe komuna tjera prej nga vijnë studentët.

- **Sekretari i FSHJM-së:** lexon kërkesën e studentit Gentian Cikaqi nr. 02-1616. Referuar dispozitave të nenit 26 të Rregullores për studime themelore, i lejohet vazhdimi edhe për një vit i studimeve themelore nga Këshilli i Fakultetit.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Hedh në votim kërkesën nr. 02-1616, e njëjta aprovohet njëzëri.

- **Bukurije Likaj:** lexon kërkesën nr. 02-1633 të studentit Florent Ramadani, programi Agrobiznes, kërkesë për vazhdim të studimeve. Në përputhje me dispozitat e Rregullores për studime themelore i lejohet vazhdimi i studimeve.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Hedh në votim kërkesën nr. 02-1633, e njëjta aprovohet njëzëri.

- **Bukurije Likaj:** lexon edhe 2 raporte mbi vlerësimin e dorëshkrimit master për studentët:
  - Anda Doda – mentor Prof. asoc.dr. Sadik Maloku, dhe
  - Erzen Pulaj – mentor Prof.asoc.dr. Shukri Maxhuni

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Hedh në votim raportet për studentët, të njëjtat aprovohen njëzëri nga KFSHJM.

- **Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Kam një kërkesë për ju të nderuar anëtarë të Këshillit të Njësisë. Me rastin e dorëheqjes së Prof.asoc.dr. Ekrem Gjokaj jemi të detyruar të plotësojmë ndyshojmë një mori komisionesh duke zëvendësuar emrin e tij.


Për arsye praktike, me qëllim të shmangjes së vonesave që shkaktohen nga plotësim ndryshimi i këtyre komisioneve në KFSHJM, kërkoj që Këshilli të mandatoj Dekanen që të plotësoj dhe ndyshoj të gjitha vendimet e Këshillit që kanë të bëjnë me zëvendësimin e Prof. asoc.dr. Ekrem Gjokaj nga ato komisione.

**Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së:** Hedh në votim kërkesën e Dekanes. Aprovohet njëzëri nga KFSHJM-së.

Në fund, **Kryesuesja e Këshillit të FSHJM-së** falënderon BKI-në, Studentët dhe Këshillin e Fakultetit për kontributin e dhënë.

**Pjesë e këtij procesverbali të bashkangjitur gjeni edhe audio-incizimi i cili mbetet në arkivin e Këshillit Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.**

**Procesmbajtësi:**  
**Skender Kokollari**



**Kryesuesja e Këshillit të Fakultetit**  
**Prof. asoc. dr. Albana Milaimi**

